



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:292816 C. nr. 2906/2021
Datë: 13.09.2024
Numri i dokumentit: 06156241

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, me bashkëpunëtorin profesional I.S. në çështjen kontestimore të paditësve I. (S) P. dhe G.(S) P. që të dy nga fshati Vërmicë - Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson E.G. avokat nga Prizreni, kundër të paditurit A. (M) K. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson M.G. juriste nga Prizreni, për vërtetimin e pronësisë, vlera e kontestit 100,00€, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datë 30 Gusht 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M
-Në bazë të pohimit-

- I. Miratohet kërkesëpadia e paditësve I. (S) P. dhe G.(S) P. që të dy nga fshati Vërmicë Komuna e Prizrenit,
- II. Vërtetohet se paditësit I. (S) P. dhe G.(S) P. që të dy nga fshati Vërmicë Komuna e Prizrenit janë bashkëpronar secili me nga $\frac{1}{2}$ të pjesë ideale në parcelën kadastrale nr. 08642-1, ZK Prizren në vendin e quajtur "Buzagilak", në sipërfaqe prej 1337 m², me masa dhe kufij: nga ana veriore 7.05, 7.60m, 13.70m dhe 1.10m, nga ana lindore 43.53m, nga ana jugore 1.13m, dhe 28.84m. Ndërsa nga ana perëndimore 45.22m. Ashtu që detyrohet i padituri A. (M) K. nga Prizreni, ta pranoj këtë dhe t'i lejoj paditësit regjistrimin e kësaj prone në librat kadastrale, në emër të paditësve, të gjitha këto në afatin prej 15 ditëve pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësit I. (S) P. dhe G.(S) P. përmes të autorizuarit të tyre pranë kësaj gjykate më datë 28.12.2021, kanë parashtruar padi kundër të paditurit A.K. nga Prizreni, duke cekur se paditësit janë pronarë faktik të ngastrën kadastrale P-71813068-08642-1, ZK Prizren në vendin e quajtur "Buzagilak" në sipërfaqe të përgjithshme prej 3930 m². Paditësit kanë theksuar se këtë paluajtshmeri e kanë blerë nga i padituri për të cilën paluajtshmeri i kanë paguar mjetet në tërësi, mirëpo të njëjtit për shkaqe objektive nuk kanë mundur që ta bartin në emër të tyre. Në shqyrtimin kryesor i autorizuari paditësve ka deklaruar se ngel në tërësi pranë padisë,

kërkesëpadisë, me ndryshimin i cili është paraqitur në raportin e ekspertit gjeodet lidhur me kufijtë kadastral. Edhe në fjalën e fundit i autorizuari i paditësve, ka deklaruar se pas administrimit të provave e sidomos ekspertizës së ekspertit të gjeodezisë në skicën e terrenit, u vërtetua se pronarë faktik me nga ½ janë I. (S) P. dhe G.(S) P. që të dy nga Prizreni, e këtë fakt nuk e ka mohuar A.M.K. këtu si i paditur, duke i propozuar gjykatës që ta miratoj në tërësi padinë si të bazuar dhe të vërtetohet se janë pronarë juridik të paluajtshmerisë P-71813068-08642-1, në sipërfaqe prej 1337 m² ZK Prizren, me kulturë arë me nga ½ pjesës ideale, sipas skicës në faqen e katërt të kufijve dhe masave të kufijve zyrtar kadastral. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

E autorizuar e të paditurit A.K. juriste M.G. në seancën e shqyrtimit kryesorë ka sqaruar se nuk e kundërshton padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, ashti siç është paraqitur në kufijtë kadastral në raportin e ekspertit gjeodet. Në këtë seancë ka kërkuar nga eksperti që të deklarohet për masat dhe kufijtë e gjendjes kadastrale. Ndërsa në fjalën e sajë përmbyllëse e autorizuar e të paditurit ka deklaruar se e pranon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke kërkuar nga gjykata që të bjerë aktgjykim për vërtetimin e pronësisë në bazë të pohimit dhe atë në masat dhe kufijtë e paraqitur nga eksperti në këtë seancë për ngastrën kontestuese sipas gjendjes kadastrale. Shpenzimet procedurale nuk i ka kërkuar.

Pavarësisht se pala e paditur e ka pranuar padinë dhe kërkesëpadinë, gjykata me qëllim të respektimit të nenit 3 të LPK-së ka marr provën përmes ekspertit gjeodet nga e cila është vërtetuar që i padituri A.K. është pronar i parcelës kontestuese dhe mbi këtë bazë mund të disponon me kërkesën.

Pasi që pala e paditur ka pohuar padinë dhe kërkesëpadinë, ndërsa në anën tjetër i padituri mund të disponon me kërkesa, pasi që është pronar i parcelës kontestuese, gjykata në kuptim të nenit 148 vendosi të miraton padinë dhe kërkesëpadinë e palës paditëse, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet për nxjerrjen e këtij loji të aktgjykimit pasi që i paditurit si personalisht në seancë e po ashtu edhe përmes të autorizuarës së vetë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 463 lidhur me nenin 452 të LPK-së, pasi që pala e cila ka fituar kontestin nuk i kërkoi shpenzimet e procedurës.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C .nr. 2906/21, më datë 30 Gusht 2024

B. Profesional,
Ilir Sërtollaj

Gjyqtari,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë në paraqitjen e ankesës, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.